

FOTO ALBUM

— 2021 —

PHOTO ALBUM

Përgatitën për botim: Dr. Ornela Arapi
Dr. Brunilda Çërraga

Redaktor: Inpress sh.p.k.

Dizajn: Inpress sh.p.k.

Copyright: Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

Shtypshkronja “**Inpress sh.p.k.**”

Prepared for publication: Dr. Ornela Arapi
Dr. Brunilda Çërraga

Editor: Inpress sh.p.k.

Design: Inpress sh.p.k.


Copyright: Authority for Information on the Former State Security Documents

Printing House “**Inpress sh.p.k.**”

AKTIVITETE 2021 / ACTIVITIES 2021

SHQIPËRIA ANTARËSOHET NË RRJETIN EUROPIAN TË AUTORITETEVE PËRGJEGJËSE PËR ARKIVAT E ISH-POLICISË SEKRETE

ALBANIA IS A MEMBER OF EUROPIAN NETWORK OF RESPONSIBLE AUTHORITIES FOR THE ARCHIVES OF FORMERS SECRET POLICIES




NË KUADËR TË TAKIMEVE VJETORE TË INSTITUCIONEVE TË RRJETIT EUROPIAN TË AUTORITETEVE PËRGJEGJËSE PËR ARKIVAT E ISH-POLICIVE SEKRETE, AUTORITETI MORI PJESË NË MBLEDHJEN ONLINE TË ZHVILLUAR NGA INSTITUTI ÇEK PËR STUDIMIN E REGJIMEVE TOTALITARE

IN THE FRAME OF ANNUAL MEETINGS OF THE INSTITUTIONS OF EUROPEAN NETWORK OF RESPONSIBLE AUTHORITIES FOR THE ARCHIVES OF FORMERS SECRET POLICIES, THE AUTHORITY WAS PRESENTED AT THE ONLINE MEETING ORGANISED FROM THE CHEQUE INSTITUTE FOR THE STUDY OF TOTALITARIAN REGIMES

28 Janar 2021 / 28 January 2021

Zyra e Ballkanit Perëndimor të ICMP (Projekti në Shqipëri) me pjesëmarrjen e Zyrës Qendrore të ICMP në Hagë, Autoritetit dhe përfaqësuesve të Bashkimit Europian në Shqipëri, organizuan online, takimin njohës dhe prezantues të përfituesve të granteve nga projekti i përbashkët ICMP-AIDSSH.

The Regional Office for the Western Balkans of ICMP (Project in Albania) with the participation of Central Office of ICMP in Hague, the Authority and the representatives of European Union in Albania, organised the online presentation meeting with the aim of representing the beneficiaries of grants from the joint project ICMP – AIDSSH.



AMBASADORI I OSBE-SË NË SHQIPËRI Z. VINCENZO DEL MONACO, TAKIM ME KRYETAREN E AUTORITETIT ZNJ. GENTIANA SULA

THE AMBASSADOR OF OSCE PRESENCE IN ALBANIA MR. VINCENZO DEL MONACO HOLD A MEETING WITH THE CHAIRWOMAN OF THE AUTHORITY, MRS. GENTIANA SULA


1 Shkurt 2021 / 1 February 2021



WORKSHOP ONLINE MBI BENEFITET E PËRDORIMIT TË RADARËVE ME PENETRIM TË THELLË PËR IDENTIFIKIMIN DHE GJETJEN E TË ZHDUKURVE

WORKSHOP ONLINE ON THE BENEFITS OF USING DEEP-PENETRATING RADARS FOR IDENTIFYING AND FINDING THE MISSING PEOPLE

3 Shkurt 2021 / 3 February 2021



Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit zhvilloi workshopin e parë online, mbi menaxhimin e të dhënave për të zhdukurit, në bashkëpunim me Zyrën Rajonale për Ballkanin Perëndimor të ICMP-së. Z.Adnan Rizvic, drejtor i menaxhimit të sistemit të të dhënave të ICMP dhe drejtues të ICMP-së, ndanë përvojën mbi 20-vjeçare të punës me të zhdukurit, në 50 vende të botës, organizimin e sistemit, centralizimin e të dhënave dhe proceset komplekse, deri në identifikimin e të gjeturve dhe mbetjeve njerëzore.

The Authority for Information on Former State Security Documents developed the first online workshop on the management of data on missing persons, in cooperation with the Regional Office for the Western Balkans of the ICMP. Mr. Adnan Rizvic, director of ICMP data system management and ICMP leaders shared over 20 years of experience working with missing persons in 50 countries around the world, system organization, data centralization and complex processes up to identification of finds and human remains.

QENDRA KOMBËTARE E LIBRIT DHE LEXIMIT DHE AUTORITETI ORGANIZOJNË AKTIVITETIN “LIBRI I BURGUT”, NË KUADËR TË MUAJIT TË KUJTESËS

THE NATIONAL CENTER OF BOOK AND READING AND THE AUTHORITY ORGANISE THE ACTIVITY “PRISON BOOK”, IN THE FRAMEWORK OF THE MONTH OF MEMORY

17 Shkurt 2021 / 17 February 2021



Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit dhe Autoriteti organizuan aktivitetin me temë “Libri i Burgut”, që pati si qëllim kryesor sjelljen në kujtesë, të një letërsie shkruar në burg, prej intelektualëve të burgosur, apo të internuar gjatë viteve të diktaturës.

The National Book and Reading Center and the Authority organized the activity with the theme “Prison Book”, which had as its main goal bringing to memory a literature written in prison by intellectuals imprisoned or interned during the years of the dictatorship.

AUTORITETI DHE ARKIVI QENDROR SHTETËROR I FILMIT, HAPAT E PARË BASHKËPUNUES

THE AUTHORITY AND CENTRAL STATE FILM ARCHIVE, COLLABORATIVE FIRST STEPS

19 Shkurt 2021 / 19 February 2021



Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit (AQSHF) çeli dyert për Autoritetin dhe propozimet konkrete, për bashkëpunim. Drejtuesja e AQSHF-së, znj. Iris Elezi, bëri një paraqitje të kujdesshme dhe të detajuar, të materialeve të tipologjive të ndryshme që ruhen në arkiv, duke evidentuar njëkohësisht elementët dhe fushat ku mund të punohet e studiohet bashkërisht.

Authority and Central State Film Archive (AQSHF) opened its doors to authority and concrete proposals for cooperation. Director of AQSHF, Mrs. Iris Elezi made a careful and detailed presentation of materials of different typologies that are stored in their archive, highlighting simultaneously the elements and areas where we can work and study together.

OSBE, TAKIM ONLINE PËR TË SHKUARËN DHE TË ARDHMEN, ME AKTORËT E KUJTESËS

OSCE, ONLINE MEETING FOR THE PAST AND THE FUTURE, WITH ACTORS OF MEMORY

22 Shkurt 2021 / 22 February 2021

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, organizoi takimin online, në kuadër të projektit “Lustracioni në Shqipëri: E shkuara dhe e ardhmja”, ku Autoriteti u përfaqësua nga kryetarja, znj. Gentiana Sula.

The Presence of OSCE in Albania organised meeting online in the framework of the project “Lustration in Albania: The past and the future”, where the Authority was represented by Mrs. Gentiana Sula, Chairwoman of the Authority.



70 VJET NGA EKZEKUTIMI I INTELKTUALËVE TË PUSHKATUAR NË TË ASHTUQUAJTURIN “GRUP I BOMBËS SË AMBASADËS SOVJETIKE”

70 YEARS FROM THE EXECUTION OF THE INTELLECTUALS SHOT IN THE SO-CALLED "SOVIET EMBASSY BOMB GROUP"

26 Shkurt 2021 / 26 February 2021



Më 26 shkurt 2021, u shënuan 70 vjet nga ekzekutimi i intelektualëve të pushkatuar, në të ashtuquajturin “Grup i bombës së ambasadës sovjetike”. Autoriteti, në bashkëpunim me familjarë dhe shoqata, i nderoi me homazhe, pranë memorialit të ngritur në Varrezat e Dëshmorëve të Kombit, Tiranë.

On February 26, 2021, it was 70 years since the execution of the intellectuals shot in the so-called "Soviet Embassy Bomb Group". The Authority, in cooperation with family members and associations, honored them with tributes at the Memorial Grave in Martyrs' Cemetery, Tirana.

"RRITJA E NDËRGJEGJËSIMIT TË PUBLIKUT PËR DREJTËSINË TRANZITORE DHE PAJTUESE: ADRESIMI I ÇËSHTJES SË PERSONAVE TË ZHDUKUR GJATË PERIUdhËS KOMUNISTE" I ICMP-AIDSSH, MBËSHTETUR NGA BASHKIMI EUROPIAN

"RAISING PUBLIC AWARENESS OF TRANSITIONAL AND RECONCILIATION JUSTICE: ADDRESSING THE ISSUE OF MISSING PERSONS DURING THE COMMUNIST PERIOD" OF ICMP-AIDSSH, SUPPORTED BY THE EUROPEAN UNION

2 Mars 2021 / 2 March 2021

U prezantua raporti vlerësues për institucionet dhe procesin në Shqipëri, i veprimtarive të projektit “Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për drejtësinë tranzitore dhe pajtuese: adresimi i çështjes së personave të zhdukur gjatë periudhës komuniste” i ICMP- AIDSSH, i mbështetur nga Bashkimi Europian, raport i përgatitur nga ICMP.

The evaluation report for the institutions and the process in Albania was presented, for the activities of the project “Raising awareness 58 Annual Report 2021 of the public for the transitional and conciliatory justice: addressing the issue of missing people during the communist period” of ICMP – AIDSSH, supported by the European Union, report prepared by ICMP.



WORKSHOP: KUR SIGURIMI MERREJ ME SHKENCË

WORKSHOP: WHEN STATE SECURITY DEALS WITH SCIENCE

12 Mars 2021 / 12 March 2021



Wikimedians of Albanian Language UG në punëtorinë edit-a-thon të intelektualëve në studimet “Kur Sigurimi merrej me shkencë”, me krijime dhe editime të profileve në wikipedian në gjuhën shqipe.

Wikimedians of Albanian Language UG in the edit-a-thon workshop of intellectuals in the studies "When Security was dealing with science", with creation and editing of profiles on Wikipedia in the Albanian language.

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI MIDIS AUTORITETIT PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH- SIGURIMIT TË SHTETIT PËRFAQËSUAR NGA KRYETARJA ZNJ. GENTIANA SULA DHE MINISTRISË SË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË PËRFAQËSUAR NGA ZNJ. EVIS KUSHI, MINISTRE

COOPERATION AGREEMENT BETWEEN THE AUTHORITY FOR INFORMATION ON FORMER STATE SECURITY DOCUMENTS REPRESENTED BY THE CHAIRMAN MRS. GENTIANA SULA AND THE MINISTRY OF EDUCATION, SPORTS AND YOUTH REPRESENTED BY MRS. EVIS KUSHI, MINISTER

18 Mars 2021 / 18 March 2021



Në mjediset e MASR, u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit midis Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit përfaqësuar nga kryetarja znj. Gentiana Sula dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, përfaqësuar nga znj. Evis Kushi, ministre.


In the premises of the MASR, the cooperation agreement was signed between the Authority for Information on the Documents of the former State Security, represented by the chairman Mrs. Gentiana Sula and the Ministry of Education, Sports and Youth represented by Mrs. Evis Khushi, minister.

DRAFTUDHËZUESI PËR FAMILJARËT E TË ZHDUKURVE NË KOMUNIZËM, NË KUADËR TË PROJEKTIT ICMP-AIDSSH "RRITJA E NDËRGJEGJËSIMIT TË PUBLIKUT PËR DREJTËSINË TRANZICIONALE DHE TË PAJTIMIT: TË ZHDUKURIT NË KOMUNIZËM", TË MBËSHTETUR NGA BASHKIMI EUROPIAN

DRAFT GUIDE FOR THE FAMILIES OF THE DISAPPEARED IN COMMUNISM, WITHIN THE ICMP-AIDSSH PROJECT "INCREASING PUBLIC AWARENESS OF TRANSITIONAL JUSTICE AND RECONCILIATION: THE DISAPPEARED IN COMMUNISM", SUPPORTED BY THE EUROPEAN UNION

18 Mars 2021 / 18 March 2021







U prezantua draftudhëzuesi për familjarët e të zhdukurve në komunizëm, në kuadër të projektit ICMP-AIDSSH “Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për drejtësinë tranzicionale dhe të pajtimit: të zhdukurit në komunizëm”, të mbështetur nga Bashkimi Europian.

The draft guide for the families of the disappeared in communism was presented, within the ICMP-AIDSSH project "Increasing public awareness of transitional justice and reconciliation: the disappeared in communism", supported by the European Union.

WORKSHOP ONLINE "PËRVOJA NË PUNËN ME SISTEMET E ARKIVAVE DIGJITALE DHE PROCESET DIGJITALIZUESE" I AIDSSH ME ARKIVIN E INSTITUTIT KOMBËTAR TË KUJTESËS NË POLONI

ONLINE WORKSHOP "EXPERIENCE IN WORKING WITH DIGITAL ARCHIVE SYSTEMS AND DIGITIZING PROCESSES" OF AIDSSH WITH THE ARCHIVE OF THE NATIONAL INSTITUTE OF MEMORY IN POLAND

26 Mars 2021 / 26 March 2021



Autoriteti mori pjesë në workshopin online "Përvoja në punën me sistemet e arkivave digjitale dhe proceset digjitalizuese" të Arkivit të Institutit Kombëtar të Kujtesës në Poloni, mbi topografinë e dokumenteve, qarkullimin dhe përdorimin nëpërmjet sistemit, të organizuar nga Drejtoria e Arkivit, në bashkëpunim me homologët polakë.

Authority participated in the online workshop "Experience in working with digital archive systems and digitization processes" with the Archive of the National Institute of Remembrance in Poland, on document topography, circulation and use through the system, organized by The Archive Directorate, in cooperation with the Polish counterparts.

NËNSHKRUHET MARRËVESHJA E BASHKËPUNIMIT MIDIS AUTORITETIT DHE AKADEMISË SË STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE

THE COOPERATION AGREEMENT BETWEEN AUTHORITY AND THE ACADEMY OF ALBANOLOGICAL STUDIES IS SIGNED

23 Prill 2021 / 23 April 2021



U nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit midis Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe Akademisë së Studimeve Albanologjike, mes znj. Gentiana Sula, Kryetare e Autoritetit dhe akademikut prof. dr. Marenglen Verli, Rector i ASA.

The cooperation agreement was signed between the Authority for Information on Former State Security Documents and the Academy of Albanological Studies, between Mrs. Gentiana Sula, Chairwomen of the Authority and academician prof. dr. Marenglen Verli, Rector of ASA.

VIZITË E PËRFAQËSISË SË FEDERATËS PANSHQIPTARE “VATRA” NË AUTORITET

VISIT OF THE REPRESENTATIVE OF THE PAN ALBANIAN FEDERATION "VATRA" TO AIDSH

21 Prill 2021 / 21 April 2021



Një përfaqësi e Federatës Panshqiptare “Vatra” vizitoi Autoritetin. Kryetari i “Vatrës”, z. Elmi Berisha, znj. Nazo Veliu, sekretare e Vatrës, Dr. Pashko Camaj, z. Mondi Rakaj, z. Anton Raja dhe z. Adriatik Spahiu, anëtarë të kryesisë, u njohën me veprimtarinë e Autoritetit, shtyllat ku mbështetet puna e institucionit dhe sfidat e përditshme.

A representative of the Pan-Albanian Federation "Vatra" visited the Authority. The chairman of "Vatra", Mr. Elmi Berisha, Mrs. Nazo Veliu, secretary of Vatra, Dr. Pashko Camaj, Mr. Mondi Rakaj, Mr. Anton Raja and Mr. Adriatik Spahiu, members of the presidency, got acquainted with the activity of the Authority, the pillars on which the work of the institution is supported and the daily challenges.

VIZITË E AUTORITETIT NË ZONËN E MALËSISË SË MADHE, KOPLIKUT DHE SHKODRËS, PËR PËRGATITJEN E AKTIVITETEVE PËRKUJTIMORE DHE PREZANTUESE TË UDHËZUESIT PËR FAMILJARËT E TË ZHDUKURVE, DËSHMIVE DHE EKSPOZITËS

VISITS OF AUTHORITY TO THE AREA OF MALËSIA E MADHE, KOPLIK AND SHKODRA, FOR THE PREPARATION OF MEMORIAL ACTIVITIES AND PRESENTATION OF THE GUIDE FOR THE FAMILIES OF THE DISAPPEARED, EVIDENCE AND EXHIBITION

20-21 Maj 2021 / 20-21 May 2021



Një ekip i Autoritetit zhvilloi udhëtime paraprake në zonën e Malësisë e Madhe, Koplikut dhe Shkodrës, për përgatitjen e aktiviteteve përkujtimore dhe prezantuese të udhëzuesit për familjarët e të zhdukurve, dëshmive dhe ekspozitës. Grupi i punës realizoi për dy ditë, takime me përfaqësues të pushtetit lokal, Kryetaren e Bashkisë Shkodër, znj. Voltana Ademi dhe drejtuesen e Muzeut Historik Shkodër, znj. Amila Gjyrezi, për bashkëpunimin ndërinstitucional.

A team of the Authority carried out preliminary trips to the area of Malësia e Madhe, Koplik and Shkodra, for the preparation of commemorative activities and presentation of the guide for the families of the missing, testimonies and exhibition. The working group held two days of meetings with representatives of the local government, the Mayor of Shkodër, Mrs. Voltana Ademi and the head of the Shkodër Historical Museum, Mrs. Amila Gjyrezi for inter-institutional cooperation.

AKTIVITET NË SHKODËR DHE NË MALËSI TË MADHE, NË KUADËR TË PROJEKTIT TË ICMP-AIDSSH “RRITJA E NDËRGJEGJËSIMIT TË PUBLIKUT PËR DREJTËSINË TRANZITORE DHE PAJTUESE: ADRESIMI I ÇËSHTJES SË PERSONAVE TË ZHDUKUR GJATË PERIUDHËS KOMUNISTE”, I MBËSHTETUR NGA BASHKIMI EUROPIAN

AIDSSH CARRIED OUT AN ACTIVITY IN SHKODRA AND IN THE GREAT HIGHLANDS, WITHIN THE FRAMEWORK OF THE ICMP-AIDSSH PROJECT "INCREASING PUBLIC AWARENESS OF TRANSITIONAL AND RECONCILIATION JUSTICE: ADDRESSING THE ISSUE OF MISSING PERSONS DURING THE COMMUNIST PERIOD", SUPPORTED BY THE EUROPEAN UNION

27-28 Maj 2021 / 27-28 May 2021




Gjatë punës në vendosjen e stendave, për aktivitetin që u zhvillua në mjediset e jashtme të shtëpisë së heroit kombëtar, Oso Kuka - tashmë, Muzeu Historik i Shkodrës.

During the work of the staff, for setting up the stands for the activity that took place outside the house of the national hero Oso Kuka, which is now the Historical Museum of Shkodra.



Përfaqësues të komuniteteve fetare myslimane dhe katolike, të Shkodrës.

Representatives of the Muslim and Catholic religious communities of Shkodra.



Ardita Repishti, Drejtore e Drejtorisë së Mbështetjes Shkencore dhe Edukimit Qytetar dhe organizatore e aktivitetit, z. Niko Brahimi, Drejtor i policisë së rrethit Shkodër.

Ardita Repishti, Director of the Directorate of Scientific Support and Civic Education and organizer of the event, Mr. Niko Brahimi, Director of the Shkodër district police.



Z. Vincenzo del Monaco, Ambasador i OSBE-së dhe Znj. Voltana Ademi kryetare e Bashkisë Shkodër gjatë fjalës së saj të rastit.

Mr. Vincenzo del Monaco, Ambassador of the OSCE, and Mrs. Voltana Ademi, Mayor of Shkodra, during her remarks on the occasion.

Media gjatë aktivitetit.

Media during the activity.





Z. Niko Brahimi, Drejtor i policisë së rrethit Shkodër, Simon Mirakaj - anëtar i Autoritetit dhe Luigj Ndoum - drejtori i projektit të ICMP për Shqipërinë.

Mr. Niko Brahimi, Director of the Shkodër district police, Simon Mirakaj - member of the Authority and Luigj Ndou - ICMP project director for Albania

Specialistja e kërkesave individuale për informim, znj. Ajkana Toni, gjatë punës për marrjen e kërkesave nga të interesuar, gjatë aktivitetit.

Specialist of individual requests for information Mrs. Ajkana Toni during the work for receiving requests from interested parties during the activity.



Drejtori i Fondacionit “Konrad Adenhauer”, dr. Tobias Rüttershoff dhe nënshtetasi danez Tue Magnussen, i cili, sapo kishte marrë dosjen që ish-Sigurimi Shtetit i kishte hapur gjatë kohës kur kishte qenë student, rreth viteve ‘70.

The director of the Konrad Adenhauer Foundation dr. Tobias Rüttershoff and Danish national Tue Magnussen who had just received his file that the former State Security had opened when he was a student around the ‘70s.



Nga e majta në të djathtë: Zenel Drangu - kryetar i Shoqatës së ish-të Përndjekurve Politikë të Shkodrës, Gentiana Sula - kryetare e AIDSSH, Ardian Kati - ish Drejtor i Qendrës së Traumës dhe Rehabilitimit, gjatë aktivitetit.

From left to right Zenel Drangu - president of the Association of Former Political Victims of Shkodra, Gentiana Sula- president of AIDSSH, Ardian Kati- former Director of the Trauma and Rehabilitation Center during the activity.




Të rinj shkodranë, të interesuar për aktivitetin e Autoritetit.

Young people from Shkodra interested in the activity of the Authority.

PRIORITET TË PAGJETURVE TË KOMUNIZMIT DHE ISH-TË PËRNDJEKURVE POLITIKË

PRIORITY OF THE MISSING OF COMMUNISM AND FORMER POLITICAL PERSECUTED

8 Qershor 2021 / 8 June 2021



Probleme thelbësore që kanë të bëjnë me të përndjekurit politikë dhe dëmshpërblimet e tyre, dokumentacionin e kërkuar nga institucionet dhe kohën e dhënies së kësteve ishin pjesë e diskutimeve. Problem i rëndësishëm, me të cilin hasen ish-të përndjekurit sot dhe trashëgimtarët e tyre, janë edhe dosjet e të internuarve, në shumë raste, me mungesa në dokumentacion. U propozua që dosjet e të internuarve, të mund të kalohen përmes bashkëpunimit ndërinstytucional dhe VKM-së përkatëse, që ndihmon plotësimin e dokumentacionit të kërkuar dhe përshpejton dhënien e dëmshpërblimeve, të internuarve në kampe me tela me gjemba.

Essential problems related to the politically persecuted and their reparations, the documentation required by the institutions and the timing of the installments were part of the discussions. An important problem faced by the ex-persecuted today and their heirs are the files of the internees, in many cases with missing documentation. It was proposed that the files of the internees could be passed through the inter-institutional cooperation and the relevant VKM, which helps to complete the required documentation and accelerates the granting of reparations to the internees in barbed wire camps.

PREZANTOHEN BOTIMET MBI MENDIMIN POLITIK TË SË MAJTËS SË PËRNDJEKUR

PUBLICATIONS ON THE POLITICAL THOUGHT OF THE PERSECUTED LEFT ARE PRESENTED

24 Qershor 2021 / 24 June 2021

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe Fondacioni “Friedrich Ebert Stiftung” në Tiranë, prezantuan botimet mbi “Mendimin Politik të së Majtës Shqiptare”, në mjediset e jashtme të Muzeut Kombëtar të Përgjimeve, “Shtëpia me gjethe”.

The Authority for Information on the Documents of the Former State Security and the "Friedrich Ebert Stiftung" Foundation in Tirana presented the publications on "Political Thought of the Albanian Left", in the outdoor areas of the National Museum of Interceptions "House of Leaves".



Kryetarja e Autoritetit, znj. Gentiana Sula, duke prezantuar projektin.

The Chairwomen of the Authority, Mrs. Gentiana Sula presenting the project.



Studiuesja Ana Lalaj, gjatë prezantimit të punimeve “Midis ëndrrës dhe zhgënjimit”, mbi figurën e Sejfulla Malëshovës dhe “Ky sfidant tragjik”, mbi figurën e të persekutuarit, Xhavid Qesja.

Researcher Ana Lalaj presenting her works "Between dreams and disappointment" on the figure of Sejfulla Malëshova and "This tragic challenger" on the figure of Xhavid Qesja.



Studiuesja Sonila Boçi, duke prezantuar punimin e saj: “Patrioti, demokrati dhe opozitari i përhershëm”, mbi figurën e Skënder Luarasi.

Researcher Sonila Boçi presenting her paper "Patriot, democrat and permanent oppositionist" on the figure of Skënder Luarasi.



Drejtori i Muzeut Historik Kombëtar z. Dorian Koçi, në cilësinë e studiuesit, duke prezantuar studimet e tij mbi Musine Kokalarin: “Profili i një shkrintareje socialdemokrate” dhe Isuf Keçin “Jeta e një ish-anëtari të Grupit Komunist të të Rinjve nën regjimin totalitar”.

The director of the National Historical Museum Mr. Dorian Koçi, as a researcher presenting his studies on Musine Kokalari "Profile of a social democratic writer" and Isuf Keçi "Life of a former member of the Communist Youth Group under the totalitarian regime."



Ilir Kalemaj, gjatë prezantimit të studimit të tij: “Isuf Luzaj - Profili i një nacionalisti socialdemokrat”.

Ilir Kalemaj with his presentation of the study on "Isuf Luzaj - Profile of a Social Democratic Nationalist".



Duke ndjekur ceremoninë, nga e majta në të djathtë: Ilir Kalemaj, Dorian Koçi, Gentiana Sula, Kryetare e Autoritetit, z. Petro Luarasi, studiues dhe z. Knut Fleckenstein, Eurodeputet, Raportuesi i PE për Shqipërinë.

Following the ceremony from left to right Ilir Kalemaj, Dorian Koçi, Gentiana Sula- Head of the Authority, Mr. Petro Luarasi researcher and Mr. Knut Fleckenstein, - MEP, EP Rapporteur for Albania.



Studiuesi Edon Qesari, duke prezantuar studimin e tij: "Zef Mala, i penduari që nuk diti të heshtë".

Researcher Edon Qesari presenting his study on "Zef Mala - The penitent who did not know how to keep quiet".



Z. Knut Fleckenstein – Eurodeputet, Raportuesi i PE për Shqipërinë, pjesëmarrës në aktivitet.

Mr. Knut Fleckenstein – MEP, EP Rapporteur for Albania, participant in the activity.

PËRGATITJE PËR AKTIVITETIN E RADHËS PËR TË PAGJETURIT E DIKTATURËS

PREPARATION FOR THE NEXT ACTIVITY FOR THE MISSING OF THE DICTATORSHIP

28-30 Qershor 2021 / 28-30 June 2021

U zhvilluan udhëtime paraprake në Sarandë, Shën Vasil, Borsh, Himarë, Porto Palermo dhe rrethina, për përgatitjen e aktiviteteve përkujtimore dhe prezantuese të udhëzuesit për familjarët e të zhdukurve, dëshmive dhe ekspozitës.

Preliminary trips were made to Saranda, Saint Vasil, Borsh, Himarë, Porto Palermo and the surrounding area, for the preparation of commemorative and presentation activities of the guide for the families of the missing, testimonies and exhibition.



Z. LUC BOUNIOL-LAFFONT, DREJTOR I DEPARTAMENTIT TË KULTURËS PRANË “MUSEES D’ORSAY” NË PARIS, ISH-ATASHE KULTUROR I FRANCËS NË SHQIPËRI, NGA VITI 1988 E DERI NË RËNIEN E SISTEMIT KOMUNIST, TËRHOQI DOSJEN E TIJ PRANË AUTORITETIT, I PRANISHËM ISHTE EDHE AMBASADORI I SHQIPËRISË NË FRANCË, Z. DRITAN TOLA

MR. LUC BOUNIOL-LAFFONT, DIRECTOR OF THE CULTURE DEPARTMENT AT THE MUSEES D'ORSAY IN PARIS, THE FORMER CULTURAL AFFACHER OF FRANCE IN ALBANIA FROM 1988 UNTIL THE FALL OF THE COMMUNIST SYSTEM, WITHDREW HIS FILE FROM THE AUTHORITY. HE WAS ACCOMPANIED BY ALBANIA'S AMBASSADOR TO FRANCE, MR. DRITAN TOLA

4 Gusht 2021 / 4 August 2021



EKSPOZITA “E SHKUARA E PAKRYER”, ME PROFILE TË TË PAGJETURVE TË KOMUNIZMIT, DËSHMI TË MBLEDHURA NGA FAMILJARË TË TË PAGJETURVE NË KUADËR TË PROJEKTIT DHE MATERIALE TË PËRZGJEDHURA NGA HULUMTIMI NË HISTORIKËT E SIGURIMIT

THE "GONE UNFINISHED" EXHIBITION, WITH PROFILES OF THE MISSING OF COMMUNISM, EVIDENCE COLLECTED FROM THE FAMILIES OF THE MISSING IN THE FRAMEWORK OF THE PROJECT AND MATERIALS SELECTED FROM THE RESEARCH IN THE HISTORIES OF SECURITY

7-8 Korrik 2021 / 7-8 July 2021

Ekipi i Autoritetit zhvilloi një udhëtim njohës e përkujtimor, si dhe takime prezantuese në zonën e Bregut dhe të Sarandës, në kuadër të projektit të ICMP-AIDSSh, për të zhdukurit gjatë periudhës komuniste, i mbështetur nga Bashkimi Europian.

The Authority's team conducted a familiarization and commemorative trip, as well as presentation meetings in the area of Breg and Saranda, within the framework of the ICMP-AIDS project for those who disappeared during the communist period, supported by the European Union.





Znj. Lindita Qendro, nënkryetare e Bashkisë Sarandë, znj. Gentiana Sula, kryetare e Autoritetit, z. Llambro Nesturi, ish-i përndjekur politik, kryetar i Bashkisë së Himarës, z. Ilir Hoxha, përfaqësuesi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

Mrs. Lindita Qendro, Deputy Mayor of Saranda Municipality, Mrs. Gentiana Sula, Head of the Authority, Mr. Llambro Nesturi, former persecuted politician, Mayor of the Municipality of Himara, Mr. Ilir Hoxha, the representative of the prosecutor's office of the judicial district of Saranda.



Z. Skënder Vrioni- Sekretar i Përgjithshëm i AIDSSH, duke prezantuar udhëzuesin për familjarët e të zhdukurve në komunizëm.

Mr. Skënder Vrioni - General Secretary of AIDS, presenting the guide for the families of those who disappeared during communism.

Pas kalasë së Porto Palermos, vend ku dikur janë vendosur për një periudhë kohe, të internuarit e kampeve me “tela me gjemba”, ekipi i Autoritetit ndalon në fshatin Shën Vasil, dikur i mbiquajtur Përparim, ku pas mesit të viteve '80, filluan të silleshin të dënuar të ndërgjegjes.

After the fortress of Porto Palermo, where the inmates of the "barbed wire" camps were once settled for a period of time, the Authority team stops in the village of Saint Vasil, once nicknamed Progress, where after the mid-80s they began to be brought convicts of conscience.



Në afërsi të fshatit, pranë varrezave, pas murit rrethues, prehen ende ish-të burgosur, të cilët kërkohen nga familjarët që kanë aplikuar pranë institucioneve shqiptare për zhvarrimin dhe identifikimin e të afërmve të tyre.

In the vicinity of the village, near the cemeteries of the residents, behind the surrounding wall, former prisoners who are wanted by their families, who have applied to the Albanian institutions for the exhumation and identification of their relatives, are still resting.

TË PAGJETURIT E ZONËS SË TEPELENËS DHE GJIROKASTRËS

THE MISSING IN THE TEPELENA AND GJIROKASTRA AREA

23-24 Gusht 2021 / 23-24 August 2021

Në Ditën Europiane në përkujtim të viktimave të totalitarizmit, ekipi i AIDSSH-së zhvilloi udhëtim njohës e përkujtimor, si dhe takime prezantuese në zonën e Tepelenës dhe të Gjirokastrës, në kuadër të projektit të ICMP-AIDSSH "Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për drejtësinë tranzitore dhe pajtuese: adresimi i çështjes së personave të zhdukur gjatë periudhës komuniste", mbështetur nga Bashkimi Europian.

On the European Day in Commemoration of the Victims of Totalitarianism, the AIDSSH team held a familiarization and commemorative trip, as well as presentation meetings in the area of Tepelena and Gjirokastra, within the ICMP-AIDSSH project "Raising the awareness of to the public on transitional and reconciliation justice: addressing the issue of missing persons during the communist period", supported by the European Union.



Gjatë aktivitetit në kampin e Tepelenës, me grupet e ndryshme të interesit.

During the activity in the Tepelena camp, with the various interest groups.



Përfaqësues të komunitetit bektashian, sheh Hysen Hormova, shefi i komisariatit Tepelenë, z. Roland Zhapa, ish-fëmijë të internuar në kampin e Tepelenës dhe familjarë.

Representatives of the Bektashi community see Hysen Hormova, the head of the Tepelen police station, Mr. Roland Zhapa, former child interned in the Tepelena camp and family members.



Fëmijë duke dëgjuar historitë e trishtueshme të bashkëmoshatarëve të tyre, të viteve 1949-1953, në kampin e Tepelenës.

Children listening to the sad stories of their peers from 1949-1953 in the Tepelena camp.



Autoriteti prezantoi për qytetarët e Tepelenës, ekspozitën “E shkuara e pakryer”, me profile të të pagjeturve të komunizmit, dëshmi të mbledhura nga familjarë të të pagjeturve, në kuadër të projektit dhe materiale të përzgjedhura nga hulumtimi në historikët e Sigurimit.

